



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2019:289480
Datë: 16.05.2024
Numri i dokumentit: 05697246

C.nr.2091/19

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i përgjithshëm gjyqtari Shaban Shala, me sekretaren juridike F.B. duke vendosur në çështjen juridike civile të paditëses N.S. nga Prizreni të cilin e përfaqëson av.D.M. nga Prizreni kundër të paditues KS “Dukagjini”, me seli në Prishtinë për shkak të kompensimit të dëmit, vlera kontestit 1,100.00 €, më datën 16.05.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M
NË BAZË TË HEQJES DORË NGA KËRKESË PADIA

I. REFUZOHET si e pa bazuar kërkesë padia e **paditëses N.S. nga Prizreni**, të cilin e përfaqëson av.D.M. nga Prizreni, me të cilën ka kërkuar që të obligohet e paditura KS “Dukagjini”, me seli në Prishtinë, që paditëses t’ia kompenson dëmin për të gjitha format e dëmit material dhe jo material të cilat rrjedhin nga aksidenti i dt.14.11.2019 më kamat ligjore duke llogaritur nga data e paraqitjes së padisë deri në pagesën përfundimtare si dhe shpenzimet e procedurës të gjitha në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

II. Secila palë i bartë shpenzimet procedurale.

A r s y e t i m

Paditësja N.S. nga Prizreni të cilën e përfaqëson av.D.M. nga Prizreni në këtë gjykatë ka parashtruar padi kundër të paditues KS “Dukagjini”, me seli në Prishtinë për shkak të kompensimit të dëmit, vlera kontestit 1,100.00 €.

I autorizuari i paditëses av.D.M. më parashtresën e dt.15.05.2024 ka deklaruar se heqë dorë nga kërkesë padia lidhur më këtë çështje kontestuese sepse palët kanë lidhur marrëveshje jashtëgjyqësore për kompensimin e dëmit material.

Prandaj gjykata në bazë dispozitave të nenit 149 të LPK-së ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit.

Numri i lëndës: 2019:289480

Datë: 16.05.2024

Numri i dokumentit: 05697246

Lidhur me shpenzimet e procedurës u vendos në bazë të nenit 450 të LPK.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
-Departamenti i përgjithshëm-
C.nr.2091/19, dt.16.05.2024

Sekretare juridike
Feriha Brando

Gjyqtari,
Shaban Shala

KËSHILLË JURIDIKE: kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejt ankese në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimit nëpërmjet kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.